



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

**PROJEKT- RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E
KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË ISTOGUT**

P R O C E S V E R B A L

Nga diskutimi publik për projekt- Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Istogut mbajtur më: **15.12.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, filluar me punë në ora **11⁰⁰**

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Arben Kabashi, Drejtor për Administratë Komunale;
2. Genc Ademaj, Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit

Diskutimi ishte i hapur për të gjithë qytetarët e pranishëm të cilët ishin ardhur për diskutimin e këtë rregullore.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi, për projekt- Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Istogut Drejtori për Administratë Komunale , z.Arben Kabashi.

Drejtori për Administratë Komunale, z.Arben Kabashi- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi diskutimin publik për projekt- Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Istogut dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për projekt- Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Istogut,
2. Propozimet e qytetarëve për draft-programin,
3. Pyetje dhe Përgjigje

Procesverbali

Drejtori për Administratë Komunale, z.Arben Kabashi, - Të nderuar qytetarë, po fillojmë me seancën e diskutimit publik me qytetarë edhe pse me një numër të vogël të qytetarëve prezent mirëpo pasi që është prania e mediave mua me duhet të filloj me prezantimin e kësaj rregullore e cila ka të beje me krijimin e këshillave të fshatrave në Komunën e Istogut dhe pastaj vazhdojmë nëse ka ndonjë pyetje apo sugjerim. Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Istogut ka të bëjë me vendimin e Kryetarit të Komunës që është zgjedh komisioni cili komision ka mbajtur tri takime për hartimin e kësaj rregullore në të njëjtën kohë ja kemi dërguar edhe kuvendit e cila e aprovon për të dal në Diskutim Publik me qytetarët e Komunës së Istogut, kjo rregullore ka qenë dhe është e publikuar në faqe të komunës dhe kanë të drejt ta shikojnë të gjithë. Atëherë po shkojmë të Neni 1 ku edhe është qëllimi i kësaj rregullore e që është bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, që për komunën tonë është hera e parë dhe vitin e ardhshëm fillojmë ta implementojm, të dhënat janë të marrura nga statuti i komunës ku ai statut i vitit 2010 është valid por vitin e ardhshëm ndryshon statuti i komunës për shkak të regjistrimit të popullsisë. Te Neni 3 është përgjegjësia e realizimit bazuar në ligjin e cila përcakton përgjegjësin e cila kalon direkt në këshilla lokal dhe udhëheqësit e këshillave që do të zgjedhën. Te Neni 4 që është përgjegjësia e komisionit i cili del direkt nga kuvendi i komunës (7 anëtarë do të jenë në përbërje të komisionit të cilët do të kenë përgjegjësi për mbajtjen e këshillave të fshatrave) 4 anëtarë prej kuvendit 2 prej partive më të mëdha 1 anëtarë nga ekzekutivi që i bie nga drejtorati për Administratë Komunale dhe një nga shoqëria civile. Të pika 6 Neni 4 i parashtrohet mediave lokale dhe njoftimi në të gjitha fshatrat e komunës së Istogut, ueb faqes zyrtare të komunës dhe rrjetet sociale. Te neni 8, ne edhe njëherë mbas këtij dëgjimi me qytetarë kemi me thirr komisionin, ku bazuar në statutin e komunës ne i kemi 5 qendra urbane i kemi 50 fshatra në komunën e Istogut realisht ne e dimë që janë 52 fshatra por ne nuk mundemi me ik statutit. Këshillat lokal do ti kenë nga 9 anëtarë do të thotë i nënti i bien të jetë kryetari i këshillit lokal dhe 8 anëtarë të atij këshilli, te përfaqësimi gjinor ne jemi bazuar në udhëzimin të cilën ju e dini që po del 50/50 e të cilën përfshihen edhe komuniteti jo shumicë ku edhe ta do të kenë përfaqësues. Te neni 6 është forma e ndërprerjes se mandatit të kryetarit të këshillit lokal. Te neni 8 është konsultimi ndërmjet komunës dhe këshillave lokal dhe me këtë pjesë ndahet përgjegjësia e komunës me qytetarët. Kjo pikë tregon mënyrën se si duhet të funksionohet si këshill lokal (të marrin pjesë në dëgjime buxhetore, takime me qytetarë, takime publike etj.) vlen të theksohet se udhëheqësi i këshillit të fshatit do të ketë një pagë ta quajmë mëditje.

Pasi që nuk pati me pyetje nga qytetarët drejtori Kabashi mbylli punimet e diskutimit publik me qytetarë dhe falënderoj ata për kohën e tyre që kishin ardhur për këtë draft rregullore.

Faleminderit shumë!

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave